



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:055048
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05492030

Ac.nr.891/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Hunaida Pasuli- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.A. nga P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E. H.-H., avokat nga Gjilani, Rr. Xxx kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën me autorizim e përfaqëson Burim Maliqi Zyrtar i Lartë Ligjorë në Zyrën e Avokatit të Komunës së Gjilanit, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit në punë, vlera e objektit të kontestit: 3,338.8 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1222/2020, të datës 07.12.2021 në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.03.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan. NDRYSHOHET pjesërisht aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, C.nr.1220/2020 i datës 07.12.2021, në pjesën lidhur me shpenzimet e udhëtimit dhe gjykohet si në vijim:

REFUZHET kërkespadia e paditëses D. A. na P. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 1,976.8 euro për shpenzimet e udhëtimit, duke e llogaritur kamatën prej 8% ne vit, nga data 14.04.2020 –data e ushtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II. REFUZHET pjesërisht ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1220/2020 i datës 07.12.2021, në pjesën lidhur me shpenzimet e ushqimit ditor në shumën prej 1,412.00 Euro, VËRTETOHET.

III. Pika e I e dispozitivit të aktgjykimit mbetet e pashqyrtuar, që ka të bëjë me shpenzimeve të procedurës në shumën prej 280.00 Euro.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1222/2020 të datës 07.12.2021 e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses D. A. dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Gjilanit, që paditëses, t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 1,412.00 euro në emër të kompensimit të ushqimit ditor, për 620 ditë të pranisë në punë për periudhën kohore 2020-2021 dhe për shpenzimet e udhëtimit në shumë prej 1,976.8 euro, për 620 ditë të udhëtimit, respektivisht shumën e përgjithshme prej 3,338.8€, duke e llogaritur kamatën ligjore prej 8% nga data 14.04.2020 (data e dorëzimit të padisë në gjykatë) si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në lartësi prej 280 euro, të gjitha këto në afat në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë pala e paditur, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kontaktimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prishë aktgjykimin e atakuar apo ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar apo që çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësja, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar përgjegje në ankesën e të paditurës duke i propozuar gjykatës që ta refuzojë ankesën ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet në tërësinë e tij.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195, par.1, pika d), si dhe nenit 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themletë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja D. A. , përmes përfaqësueses të saj me autorizim E. H.-H., avokate nga Gjilani, më datën 14.04.2020, ka dorëzuar padi për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe shpenzimet e udhëtimit për punë. Në seancën e datës 02.12.2021, ka bërë ndryshimin e padisë në kuptimin e objektiv ashtu ka kërkuar nga gjykata ta detyrojë të paditurën që paditëses t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 1,412.00 euro në emër të kompensimit të ushqimit ditor, për 620 ditë të pranisë në punë për periudhën 2020-2021, për shpenzimet e udhëtimit në shumë prej 1,976.8 euro, për 620 ditë të udhëtimit, respektivisht shumën e përgjithshme prej 3,338.8 €, duke e llogaritur kamatën ligjore prej 8% nga data 14.04.2020 (data e dorëzimit të padisë në gjykatë)si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në lartësi prej 280 Euro, të gjitha këto, në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës, në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me ligj, duke theksuar se Gjykata Themelore në Gjiilan nuk ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, meqë e kompetencës lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, e po ashtu ka theksuar se Komuna e Gjiilanit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, meqë nënshkrues të Kontratës së lartcekur janë MASHT-i (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe SBASHK-u (Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës) dhe se kontrata kolektive nuk prodhon efekte juridike për të paditurën, ngase e paditura nuk është nënshkruese e Kontratës. Po ashtu i ka kundërshtuar edhe ditët e punës shtesë ku ka konsideruar se ditët shtesë janë llogaritur në periudhën kur kontrata nuk ka qenë në fuqi dhe kjo vërtetohet nga vërtetimi me nr.46/2021 të datës 29.04.2021 ku ditët e punës janë të llogaritura pas skadimit të afatit të Kontrates Kolektive të Arsimit konkretisht pas dates 18.04.2020, gjithashtu e ka kundërshtuar kërkesën për shpenzimet e udhëtimit me arsyetim se paditësja nuk ka sjell prova relevante për relacionin e udhëtimit për të cilat kërkon kompenzim dhe kjo kontratë zbatohet vetëm për të paditurit që janë banorë të Komunës së Gjiilanit. Andaj ka kërkuar që padia dhe kërkesë padia e paditëses të refuzohet si e bazuar në ligj.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1222/ 2020, të datës 07.12.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja është në marrdhënie pune në SHML Gjimnazi “Zenel Hajdini”, në Gjiilan. Paditësja, në SHFML Gjimnazi “Zenel Hajdini”, në Gjiilan ka orë shtesë dhe atë 110 ditë, ngase një fakt i tillë është vërtetuar nga vërtetimi me numer 46/21 i datës 29.04.2021, ku e njejtja prej datës 14.09.2020 deri më datën 17.04.2021 ka gjithsej 110 ditë orë mësimi. Lidhur me pretendimet e të paditurës për kompetencë, gjykata konstaton se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat Nr. 06/L-054 në nenin 12.1 shprehimisht është përcaktuar se “*Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe*. Kurse Departamenti për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat, gjykon çështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktin administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorëve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës Nr. 03/L-149 marrëdhënia juridike e tyre rregullohet me këtë Ligj. Gjykata po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditësit edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit (*Kontrata nr.24. e datës 18.04.2017/22.01.2021*), pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të, në territorin e Republikës së Kosovës. Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimin e të paditurës ku ka theksuar se paditësja fillimisht nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative para se të paraqes padi në gjykatë, mirëpo për gjykatën edhe ky pretendim i të paditurës është i pabazuar, meqë e drejta e punës është

kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësja brenda afatit të cekur më lartë mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore për kërkesat të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës në para, mirëpo kjo nuk nënkupton se paditësi nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike të e paditura ashtu siç pretendon e paditura. Në fund, gjykata e shkallës së parë vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar duke e bazuar vendimin e vet në nenin 35 paragrafi 5 dhe 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e vitit 2017. Për sa i përket kamatës dhe kamatëvonesës prej 8% në vit, gjykata e shkallës së parë vendosi duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve procedural vendosi sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke shqyrtuar ankesën e të paditurës brenda kufijve të saj, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m), si dhe për zbatimin e së drejtës materiale vjen në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera që pretendohet me ankesë, gjendja faktike është konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpenzimet e udhëtimit për paditësen andaj, për këtë gjë u desh që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të gjykohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, e po ashtu nuk ka kundërthënë në mes arsyetimit të aktgjykimit dhe përmbajtjes së provave të administruara, për pjesën e vërtetuar në emër të kompensimit të ushqimit ditor-shujtë në shumë prej 1,412.00 Euro.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk është nëshkruar nga Komuna e Gjilanit si autoritet i veçantë, nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nëshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare, e kjo për faktin se gjykata e shkallës së dytë vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedhë se obligimi për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura dhe në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet

implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësve, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata e Apelit vlerëson se, në rastin konkret është detyrim i të gjitha institucionet edukativo arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura t'i përmbush, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të drejtat tjera të cilat u përkasin punonjësve të arsimit ku sipas nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është përcaktuar zbatimi i kësaj kontratë " 1. Për të drejtat dhe obligimet që nuk janë përfshirë në këtë Kontratë, zbatohet legjislacioni në fuqi dhe Kontrata kolektive e përgjithshme. 1.1. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK - ut. 1.2. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT - in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo - arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, thëniet e të paditurës se kërkesëpadia duhet refuzuar, nga shkak se nënshkruesit e marrëveshjes nuk ia kanë siguruar të paditurit mjetet për buxhet për pagesë nuk janë të bazuara, duke marrë parasysh se ai shkak i cili do ta lironte të paditurën nga përgjegjësia, nuk është paraparë as me dispozitat e ligjit e as të Kontratës kolektive, e as përfaqësuesi i të paditurit nuk ka provuar në ndonjë mënyrë tjetër se thëniet e tij janë të bazuara.

Po ashtu, Gjykata e Apelit i refuzon si të pathemelta pretendimet ankimore të palës së paditur e cila në ankesë thekson se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar në pikëpamje të nenit 78 pika 1 të Ligjit të Punës 03/L-211 ngase paditësja nuk i ka shtjerr mjetet e mbrendshme në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Gjykata e Apelit thekson se e drejta e punës është kategori kushtetuese e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, dhe në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (*kërkesat materiale*) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, (sepse në rastin konkret nuk bëhet fjalë për procedurat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës ku aplikohet neni 78, neni 79 dhe neni 82 i Ligjit të Punës) e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës", andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësit në asnjë rrethanë nuk mund ti mohohet e drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura.

Për sa i përket pretendimit ankimor të palës së paditur se gjykata e shkallës së parë ka llogaritur gabimisht ditët e pranisë në punë për të paditurën pas datës 18.04.2020 sepse këto ditë

janë llogaritur pas skadimit të afatit të Kontratës Kolektive e cila ka qenë në fuqi deri me datën 18.04.2020, Gjykata e Apelit thekson se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur me datën 18.04.2017 ka qenë e aplikuar nga data 18.04.2017 e deri me datën 21.01.2021 sipas Mendimit Juridik për Shpërblimin Jubilar të Gjykatës Supreme të Kosovës 40/2023 të datës 27.02.2023, andaj pretendimi i tillë refuzohet si i paqëndrueshëm.

Mirëpo, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses për shpenzimet e udhëtimit. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Me dispozitat e nenit 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 4 përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Po ashtu me nenin 35 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë parashihet se *“Punonjësve arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhetn shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit, nuk e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, për arsye me rastin e vlerësimit të pretendimeve ankimore të palës së paditur, Gjykata e Apelit gjeti se rezultojnë të bazuara, pretendimet anikomore e të paditurës për sa i përket pjesës së kërkesëpadisë së paditëses për shpenzimet në emër të udhëtimit në shumë prej 1,976.80 euro, për faktin se paditësja me asnjë provë nuk i kanë vërtetuar shpenzimet e krijuara me rastin e udhëtimit ngase në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë një faturë e cila do të vërtetonte shumën e saktë e cila është shpenzuar ashtu sikurse parashihet me nenin 5 të Kontratës Kolektive. Sipas nenit 319 paragrafi 1 të LPK-së *“secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”* kurse neni 322 paragrafi 2 parasheh që *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*, andaj gjykata për këtë arsye vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në këtë pjesë si të pa bazuar.

Pika e I e dispozitivit të aktgjykimit mbetet e pashqyrtuar bazuar në nenin 194 të LPK-ës, që ka të bëjë me kompensimin e shpenzimeve të procedurës në shumën prej 280.00 Euro, me arsyetim se asnjëra palë ndërgjyqëse nuk e ka atakuar këtë pjesë me ankesë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palës së paditur, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lart, e në pajtim me nenin 194, 195 par 1, pika d) dhe e) lidhur me nenin 201 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.891/2022, datë 19.03.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Ardian Ajvazi

Numri i lëndës: 2020:055048
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05492030